



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0686

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Kryetare, Isa Hasani Anetar dhe Batisha Ibrahim Anetare duke vendosur sipas ankesës së OE C.I.K, kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore” me numër të prokurimit 651-24-5205-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN, më 19/09/2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e C.I.K me nr. 2024/0686, e datës 29/07/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore” me numër të prokurimit 651-24-5205-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Gjilanit.

2. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Gjilanit, në lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankesues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 24.05.2024 Komuna e Gjilanit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore” me numër të prokurimit 651-24-5205-2-1-1.

Ndërsa me datën 12.07.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE “KosovaMed Healthcare SHPK”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 496,224.00 €

Me 17.07.2024 OE C.I.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 18.07.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 29.07.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE C.I.K me nr. 0709/2024 lidhur me aktivitetin “Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore” me numër të prokurimit 651-24-5205-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues C.I.K janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) : “AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave nuk i ka trajtuar të gjithë tenderuesit në mënyrë të barabartë. Këtë e themi sepse OE që e ka shpallur fitues ka pasur mangësi të theksuar dhe AK nuk i ka atribuar fare, duke bërë favorizim të hapur ndaj tij. Ky OE nuk është vlerësuar drejt sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe sipas dispozitave ligjore të cilat e parashohin që secila dëshmi mbi mundësitë teknike dhe profesionale duhet ti paraprijë periudhës kohore para publikimit të njoftimit për kontratë. Licencimi pas datës së publikimit të Njoftimit për kontratë dhe prezantimi i kontratave të realizuara kinse nga natyra e projektit pa qenë fare i licencuar, janë vetëm disa dëshmi që tregojnë se AK e ka favorizuar hapur këtë OE. Arsyetimin e detajuar mbi pretendimin se AK pa asnjë bazë ligjore e ka cilësuar si të përgjegjshëm OE që e ka shpallur fitues do ta shpalosim tek pretendimet tjera. Veprimi i tillë i AK-së përbën një veprim anti ligjor dhe diskriminues ndaj neve përkatësisht përbën veprim favorizues të tenderuesit që e ka shpallur pa drejtësisht si fitues. Bazuar në këtë lirisht mund të themi se AK gjatë procesit të vlerësimit ka vepruar plotësisht në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së dhe në kundërshtim me parimet bazë të prokurimit mbi trajtimin e drejtë dhe favorizimin e tenderuesve.

Pretendimi i dytë (II) : “AK ka shkelur nenin 10 dhe 11 të LPP-së pasi që edhe përkundër kërkesës tonë dhe lejitimit nga LPP që të kemi qasje në tenderët e OE tjerë, AK nuk na ka lejuar qasje tek tenderi i OE të shpallur fitues. AK është thirrur në një kërkesë për sekret afarist të OE të shpallur fitues po ajo kërkesë nuk e plotëson kushtin e kërkuar nga nenin 11 i LPP-së për tu pranuar si e rregullt. Arsyeja pse mendojmë se kërkesa e tillë nuk është dashur të pranohet si e rregullte është se nuk e plotëson asnjërin nga paragrafët e nenit 11.3 të LPP-së. Kjo kërkesë nuk tregon askund se çka duhet cilësohet si sekret afarist, pra cili nga dokumentet duhet të mos

tregohet si dhe nuk posedon as deklaratën me arsye se pse zbulimi i dokumenteve do të i 5/13 krijoj ndonjë dëme financiar apo afarist kompanisë në fjalë. AK ka bërë shkelje edhe të nenit 10 dhe 11 të LPP kur nuk na i ka dhënë dëshmitë dhe se ka mbajtur sekrete afariste dëshmi që nuk bien në grupin e dëshmimeve sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së. Imagjino, as listën e çmimeve nuk na e ka dhënë! Ja si e kërkon nenin 11 i LPP që kjo deklaratë të jetë e plotësuar: Si rezultat i kësaj ne nuk kemi njohuri të sakta se çka ka plotësuar e çka jo nga kërkesat e dosjes së tenderit dhe se fakti që çmimi i ofruar është jo-normalisht i ulët na bënë të dyshojmë se ky OE ka mungesa të theksuar anë tenderin e tij. AK ka shkelur nenin 10 dhe nenin 11 të LPP-së edhe me rastin e mos përgatitjes së versionit të pastruar të dokumenteve sipas kërkesë së paragrafit 4 dhe 5 të nenit 11 të LPP-së sepse nuk i ka përgatitur dokumentet sipas kërkesave të këtyre paragrafëve. Nisur nga këto dhe mbështetur çdo herë në këto dispozita ligjore që flasin për transparencën në aktivitetet e prokurimit, e sidomos në pikën 3 të nenit 10 të LPP-së dhe në pikën 3 të nenit 11 të LPP-së shihet hapur se AK ka shkelur plotësisht nenin 10 dhe 11 të LPP-së.”

Pretendimi i tretë (III) : “AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë ri-vlerësimit, krahasimit dhe sqarimit të tenderëve nuk i ka aplikuar drejtë kërkesat e përcaktuara paraprakisht në dosjen e tenderit të publikuar si dokument bazë për përgatitjen e tenderëve. AK ka bërë shkelje të plotë të nenit 59 të LPP-së me rastin e cilësimit si të përgjegjshëm të OE që më pas e ka shpallur fitues, edhe pse i njëjti ka mangësi shumë të theksuara në tenderin e tij. Mangësitë në tenderin e tij që kemi mundur të i vërejmë tek dokumentacioni i pakët që na ka ofruar AK-ja, janë si në vazhdim. AK tek pika 7.1&7.2 e FDT-së ka kërkuar: 6/13 • Kërkesa e parë nuk është plotësuar pasi që ky OE posedon certifikatën e kërkuar tek pika 2 vetëm për ofrim të shërbimeve sociale në nivelin LOKAL që i bie se mundet të operoj vetëm në Komunën e Prishtinës. Logjikisht nuk mundet të operoj në nivel nacional me një licencim për nivel lokal. Pra ky OE ka dështuar ta plotësojë në këtë pikë të kërkesave andaj edhe konsiderohet se është tenderues i papërgjegjshëm. Licencimin e institucioneve për ofrim të shërbimeve sociale e menaxhon e kontrollon dhe e Licencon Ministria e Drejtësisë Departamenti i politikave Sociale dhe ky Licencim përmban tri nivele: Organizata dhe institucione që janë të licencuara për shërbim në Nivelin Lokal, në Nivelin Regjional dhe në nivelin Nacional, që nënkupton se OE fitues ka licence për këtë fushe veprimtari vetëm në nivel lokal e jo në territorin e Republikës së Kosovës. • Nisur nga fakti se sipas LPP-së, dhe RRPP-001/2022 çdo dëshmi e përshtatshmërisë profesionale konsiderohet e pranueshme vetëm po që se një e tillë është fituar para datës së Publikimit të Njoftimit për Kontratë, i bie licenca për Ambulancë Specialistike të Mjekësisë Familjare e lëshuar me datë 10.06.2024 të mos jetë e pranueshme. Mos plotësueshmëria e këtij kriteri dhe papranueshmëria e kësaj certifikate e bëjnë këtë OE plotësisht të papërgjegjshëm. • AK si përvojë për kompanitë ka kërkuar edhe kontrata nga natyra e njëjtë me projektin në tre vitet e shkuara të përfunduara para datës së njoftimit për kontratë dhe atë në vlerë 600,000.00€. Ky OE ka paraqitur tre të tilla por që ligjërisht janë të papranueshme pasi që ofrimi i shërbimeve të tilla është bërë kur kjo kompani nuk ka qenë e licencuar nga asnjëra nga instancat kompetente. Kjo i bie sikur të i pranohet përvoja e punës një doktori akoma pa diplomuar. Se përvoja e kërkuar nuk mund të pranohet pa u fituar e drejta për kryerje të punës apo aktivitetit të tillë, ka edhe interpretim nga KRPP si dhe ka vendime të OSHP-së që e kanë sanksionuar pranimin e përvojës para se të fitohet titulli apo e drejta për ofrim/kryerje të shërbimeve/punëve të tilla. Pra kur një kompani nuk është e licencuar për shërbime të tilla dhe dëshmon se ka realizuar shërbime, e sidomos në rastin konkret që bëhet fjalë për jetën e njeriut, jo që nuk duhet pranuar si përvojë por edhe përbën bazë për hetim pasi që ka ushtruar një veprimtari në mënyrë ilegale duke 7/13 rrezikuar jetën e njeriut. E themi këtë edhe për faktin se një here edhe është gjobitur dhe iu është ndaluar puna nga inspektorati shëndetësor për këtë arsye. Për tu bindur me këtë mjafton të qaseni tek linku: <https://insajderi.org/kosovamed-health-care-qe-perfitoiqindra-mijera-euro-nga-komuna-e->

drenasit-operoi-pa-licence-nga-msh-ja/ ose edhe të komunikoni me Inspektoratin Shëndetësor lidhur me dënimet dhe të drejtën apo jo të operimit pa licencë. Me që shërbimi shëndetësor në nivel të Republikës së Kosovës monitorohet, menaxhohet, organizohet dhe licencohet vetëm nga niveli qendrorë i Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës dhe nga Ministria Punës dhe Mirëqenies Sociale (tani Ministria e Drejtësisë) atëherë në bazë të dëshmive që ka ofruar ky OE i bie se krejt këto shërbime janë kryer pa u monitoruar dhe si të tilla e kanë vlerën zero. Pra nisur nga kjo i bie se ky OE nuk posedon dëshmi të vlefshme për projekte të realizuara në tre vitet e shkuara dhe se kontratat e tilla nuk mund të i pranohen çka e bëjnë këtë OE plotësisht të papërgjegjshëm. • Çmimet e ofruara për disa shërbimeve janë çmime jo-normalisht të ulëta të cilat AK nuk i ka trajtuar fare. Me që AK në kundërshtim me nenin 10 dhe 11 të LPP-së nuk na i ka dhënë shumë dokumentet e ndër të cilat është edhe lista e çmimeve, kërkojmë nga OSHP që ta kontrolloj detalisht listën e çmimeve nga aspekti i çmimeve jo normalisht të ulëta si dhe nga aspekti i spekulimit apo manipulimit me çmime. Krejt këto mangësi dhe shumë mangësi tjera tek pjesa e dokumenteve që ne nuk i kemi pasur në dispozicion e bëjnë këtë OE të papërgjegjshëm dhe AK-në e bëjnë shkelëse të plotë të nenit 59 të LPP-së. Për tu bindur edhe ju me mangësitë që i cekëm, mjafton të shikoni datën e njoftimit për Kontratë, datën e licencave dhe datat e realizimit të projekteve që AK i ka pranuar si të rregullta edhe pse nuk do duhej. Shikoni në vazhdim dëshmitë: 8/13 9/13 10/13 11/13 Pra sipas kësaj po shihet kontratat e tilla janë të nënshkruara dhe të realizuar në kohën kur kjo kompani nuk ka pasur të drejtë të ofroj shërbime të tilla dhe ka edhe asi që janë edhe të papërfunduara akoma. Bazuar në këtë del që referencat e tilla janë të papranueshme andaj ky OE për mangësin e tillë do duhej cilësuar plotësisht i papërgjegjshëm. Edhe çështja e licencës vetëm për nivel lokal dhe licencës së fituar nga Ministria e Shëndetësisë pas njoftimit për kontratë që shihen nga fotot e paraqitura e bëjnë OE tillë plotësisht të papërgjegjshëm. Pra sipas krejt kësaj shihet se AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së me rastin e vlerësimit të tenderëve andaj kërkojmë nga OSHP që pas trajtimit të të gjitha fakteve dhe dëshmive që ne i kemi paraqitur, dhe pas krahasimit të tyre me dosjen e tenderit dhe dispozitat adekuate ligjore, ankesa e jonë të cilësohet e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.”

Pretendimi i katërt (IV) : “AK ka shkelur nenin 61 të LPP-së dhe nenin 43 të RRPP-së pasi që nuk i ka respektuar dispozitat në të cilat thuhet se çdo tender jo normalisht i ulët apo ndonjë çmim i cili duket të jetë jo normalisht i ulët, fillimisht duhet trajtohet sipas kërkesave të neneve në fjalë e mandej të vendoset për atë çmim. AK nuk e ka bërë këtë andaj mendojmë se ka vepruar në kundërshtim të plotë me nenin 61 të LPP-së dhe në kundërshtim të plotë me nenin 43 të RRPP-001/2022. Edhe pse nuk e kemi pasur listën e çmimeve në shikim, ne dyshojmë se ngjashëm si në tenderët tjerë, ky OE ka në mesin e çmimeve të ofruara, çmime jo normalist të ulëta.”

Pretendimi i pestë (V) : “AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së pasi që nuk i ka respektuar fare kriteret dhe kërkesat që vet i ka vendosur në përputhje me nenin 69 të LPP-së. Mos respektimi i dëshmive për 12/13 projektet e realizuar në përputhje me ligjin dhe me atë që detyrimisht pranohet përvoja vetëm pasi të jetë fituar e drejta për të punuar atë lloj pune apo shërbimi, përbën shkelje të plotë të nenit 69 të LPP-së. Këtë e vëreni nëse i shihni me kujdes dëshmitë e paraqitura në tenderin e OE të shpallur fitues të cilat tregojnë se të gjitha si shërbime janë kryer në kohën kur ky OE nuk ka qenë i licencuar për shërbime të tilla dhe nuk ka pasur të drejtë as të ofroj shërbimet në fjalë. Po që se paraqite ky fenomen tek organet e drejtësisë dhe ato mbikëqyrëse të MD-së dhe MSH-së, ky OE rrezikon edhe të penalizohet me marrje licence.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE C.I.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Neni 7, 10, 11, 59, 61, 69 të LPP-së si dhe 43 të Rrpp-së. Pas

gjithë këtyre sqarimeve dhe fakteve të ofruara shpresojmë dhe besojmë se OSHP do ta shqyrtoj me kujdesë ankesën tonë dhe njëherit do ta aprovoj si të bazuar, duke marrë: Vendim të Aprovohet si e bazuar ankesa e OE C.I.K. “Caritas Kosova” lidhur me tenderin “Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore“ i iniciuar dhe administruar nga Kuvendi Komunal-Gjilan. Anulohet njoftimi mbi vendimin e AK - Kuvendi Komunal- Gjilan dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim. Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në dispozitat e LPP-së e që realisht më pas do duhej që Fitues të shpallej OE C.I.K. “Caritas Kosova”

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: “Ju njoftojmë që hapja e Ofertave për këtë aktivitet të Prokurimit është bërë me datë 08.07.2024 ashtu siç është specifikuar në DT si dhe në Njoftimin për Kontratë, si në vijim gjeni të bashkangjitur pjesën nga DT si dhe Procesverbalin e Hapjes së Ofertave të po asaj date. Çdo dokument që krijohet / formulohet para Hapjes së Ofertave është çështje e Operatorëve Ekonomik në fjalë që shpresim interesin për të ofertuar. Bazuar në atë çfarë u potencua, theksojmë që ne si AK — Autoritet Kontraktues çdo dokument që krijohet pas hapjes së ofertave është e papranueshme. Operatori në këtë rast KosovaMed Healthcare SH.P.K. bazuar në ofertën e tij të dorëzuar specifikohet Licenca e tij që daton me 10.06.2024 që do të thotë, para hapjes së ofertave për këtë aktivitet të Prokurimit. Bazuar në Rregullore Nr.001/2022 Për Prokurimin Publik, më saktësisht: Neni 7 Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion. 7.1 Tenderët në proces të tenderimit dorëzohen në baza konfidenciale. Në mënyrë që të ruhet integriteti i procesit dhe të respektohet pozita komerciale dhe konkurrese e tenderuesve, detajet e tenderëve, përveç informatave të cilat komunikohen gjatë seancës publike të hapjes, duhet të mbesin sekrete, deri në publikimin e rezultatit mbi vendimin e AK. 7.2 Qasja në të dhënat e aktivitetit të prokurimit fillon në datën e pranimit nga OE të njoftimit mbi rezultatit e aktivitetit të prokurimit -publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK. 7.3 Pas publikimit të rezultatit mbi vendimin e AK vetëm informatat e klasifikuara nga OE dhe të pranuar nga AK si sekrete të biznesit do të mbesin sekrete për të gjitha palët duke përfshirë KRPP, OSHP, përfshirë ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues dhe gjykatat kompetente. 7.4 Përveç dokumenteve të klasifikuara si informata sekrete afariste, AK do të ofroj, çdo palë të interesuar që bënë kërkesë, qasje të shpejtë dhe të arsyeshme në të gjitha të dhënat për aktivitetin e prokurimit. Pala e interesuar në fjalë do të ketë qasje në dokumente ditke konsultuar ato në zyrën e prokurimit. Konsultimi në zyrën e prokurimit, nëse bëhet fjalë për më pak se 20 faqe A4 dhe qasje direkte të formës elektronike do të jenë të lira nga tarifa. 7.5 Informacionet të cilat mund të klasifikohen si informacione sekrete afariste janë: a. informacionet në lidhje me pasqyrat ekonomike dhe financiare, neni 68 i LPP-se; dhe b. informacionet në lidhje me mundësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 69 i LPP-se. 7.6 Informacionet mund të klasifikohen si konfidenciale vetëm nëse: a. Operatori Ekonomik, përveç se i identifikon ("markon") dokumentet si "sekret afarist" gjatë ngarkimit të tyre në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik, i njëjti duhet të plotësojë Aneksin 3 të Dosjes së Tenderit "Kërkesa për sekret afarist". b. Nëse Operatori Ekonomik konsideron që informatat e dorëzuara sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së të trajtohen nga Autoriteti Kontraktues si informata sekrete afariste në përputhje me nenin 11 të LPP-së, i njëjti duhet të shkarkojë nga sistemi Aneksin 3 "Kërkesa për sekret afarist", të plotësojë duke dhënë arsyetimet për secilin dokument të identifikuar si "sekret afarist", nënshkruaj dhe vulos aneksin, si dhe ta ngarkojë në sistem së bashku me dokumentet tjera të tenderit të tij. 7.7 Është përgjegjësi e AK-së për të siguruar që pjesët të cilat janë deklaruar si sekret afarist nuk janë vënë në dispozicion Operatorëve të tjerë ekonomik. Atëherë ne si AK - Autoritet Kontraktues në mënyrë që të jemi sa më transparent, kemi dorëzuar të gjitha dokumentacionin e kërkuar nga ana juaj në kuadër të versionit të pastruar të dokumenteve. Me datë 15.07.2024, Ju është lejuar qasja në dokumente zyrtare, ku ju si palë e kënaqur keni

konfirmuar që gjithçka është në rregull. Vlen të potencohet që në procesverbalin e mbajtur me date 15.07.2024, dokumentet e kërkuara dhe të dorëzuara nga ana jonë janë si në vijim : certifikatat e regjistrimit komercial në vendin e tyre të themelimit, lista e kontratave të realizuara sipas Aneksit 6 të DT, Certifikata apo Licenca valide për ofrimin e shërbimeve të kërkuara e lëshuar nga Institucionet e Republikës së Kosovës- kopje, Licenca valide nga Ministria e Shëndetësisë-kopje , Raporti i Vlerësimit si dhe çdo dokument tjetër që nuk është i kufizuar si sekret afarist dhe të dhënave personale. Përgjigja e AK lidhur me këto pretendim është se : Udhëzues Nr.001/2023 Për Prokurimin Publik : 11. Tenderët Jo-normalisht të Ulët 11.1 Në çdo rast kur tenderët duken Jo normalisht të ulët, Autoriteti Kontraktues do të veproje në përputhje me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik.Gjithashtu Sipas nenit 59, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është kompetencë dhe përgjegjësi e plotë e Autoritetit Kontraktues. Kështu që, sipas Rregullave për tenderët Jo normalisht të ulët neni 3 paragrafët 3.1 dhe 3.2. 3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme: **i.** çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimimesatari tenderëve të përgjegjshëm; **ii.** çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; **iii.** janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë. Si përfundim, pretendimi juaj lidhur me këtë çështje bie Poshtë për arsye që të llogaritet çmimi abnormalisht i ulët, duhet të jeni më shumë se 3 Oferta. Dhe, në këtë rast kanë ofertuar vetëm Dy Operatorë Ekonomik. Përgjigje për Pretendimin nr. 5 Autoriteti Kontraktues (AK) - në harmoni me Nenin 1 Qëllimi, Nenin 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti dhe Nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi ka hartuar DT duke specifikuar kriteret të cilat nuk e kufizojnë konkurrencën nuk diskriminon kundër ose vepron në favor të ndonjë OE. Rrjedhimisht, AK - Autoriteti Kontraktues qëndron mbrapa Njoftimit të Autoritetit Kontraktues dhe Letrave Standarde - të datës 12.07.2024— Duke parë pretendimet tuaja Ankimore ne si AK kemi shqyrtuar në detaj këto të fundit. Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 01/08/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0686/2024, ndërsa me datë 08/08/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0686 me rekomandimet si në vijim:Duke pasura parasysh pretendimet ankimore, kriteret e vendosura ne dosjen e tenderit, shqyrtimin e tyre dhe krahasimin e dokumentacioneve të ofruara nga ana e OE të rekomanduar, që të refuzoj ankesën e operatorit ekonomik ankues si te pa bazuar dhe njëkohësisht te mbetet ne fuqi Formulari B58 mbi njoftimin e vendimit nga AK lidhur me këtë aktivitet.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE Nuk Pajtohet lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe

dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE C.I.K eksperti shqyrtuese përmes raportit nr. 2024/0686 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): “Përgjigja e ekspertit shqyrtues ndaj pretendimit ankimore nr.1: Gjatë shqyrtimit të procedurës në sistemin e e-prokurimit OE ankues me datën 12.07.2024 ka paraqitur kërkesën për qasje në dokumentet e OE të rekomanduar, me datën 15.07.2024 AK ka kthyer përgjigje lidhur me kërkesën për qasje me që rast ka lejuar qasjen. Përgjigja për lejimin e qasjes në dokumente. Kërkesa për qasje e bërë nga ana e OE ankues. OE, i rekomanduar me rastin e ofertimit në ofert ka dorëzuar edhe Formularin e Ankesit nr. 3 ku ka kërkuar nga AK që disa nga dokumentet të klasifikohen si konfidenciale në kuptim të Nenit 11 të LPP-së. Në bazë të kësaj AK konform LPP ka nxerru vendim ku të nejtën ka aprovuar pjesërisht kurse për disa dokumente të cilat konsiderohen që nuk mundën të dëmtojnë OE ekonomik ka lejuar qasje për OE ankues sipas kërkesës, andaj bazuar në këtë në cilësinë e ekspertit shqyrtues konstatohet se OE iu është lejuar qasja konform LPP dhe kërkesës dhe pretendimi ankimore është i pa bazuar.”

Konstatimi i dytë (II) : “Përgjigja e ekspertit shqyrtues ndaj pretendimit ankimore nr.2: Eksperti shqyrtues sqaron se AK në FDT tek kapaciteti teknik dhe profesional pika 7.1&7.2. Operatori ekonomik i rekomanduar konform kërkesës së FDT pikës 7.1 dhe 7.2 kërkesës nr.2 ka prezantuar Licencën e cila ka vlefshmërinë e saj deri me dt.28.02.2027.Në cilësinë e ekspertit shqyrtues konstatohet se Licencat e prezantuara nga ana e OE të rekomanduar janë konform kërkesës së FDT-së, kërkesës nr.2 dhe të njëjtat konstatohet se plotësojnë kriterin e kërkuar, e njëjta është konform Ligji Nr. 08/L-255 Për Shërbime Sociale dhe Familjare.Sa i përket pretendimit të licencës është vetëm për nivel lokal, eksperti shqyrtues sqaron se AK në FDT tek kjo kërkesë nuk ka specifikuar se licenca duhet të jetë për nivel lokal apo nivel qendror, megjithatë nisur nga aspekti legjislativ dhe ndarja e pushteteve në Republikën e Kosovës, aktiviteti i prokurimit në fjalë është zhvilluar nga Niveli Lokal këtë rast Komuna e Gjilanit dhe Jo nga niveli qendror (Ministri apo diskaster tjetër) andaj licenca konstatohet se plotëson kriterin e kërkuar nga AK - Komuna e Gjilanit dhe pretendimi ankimor konstatohet se është i pa bazuar.Operatori ekonomik i rekomanduar konform kërkesës së FDT pikës 7.1 dhe 7.2 kërkesës nr.3 ka prezantuar Licencën nga MSH e cila ka vlefshmërinë e saj deri me dt.09.06.2029. Eksperti shqyrtues gjatë shqyrtimit të pretendimit ankimore, kriterit të FDT-së nr.7.1 dhe 7.2 kërkesa nr.3 konstaton se OE i rekomanduar ka prezantuar Licencën nr.219/2024 dhe vendimin nga MSH nr.219/2024 për licencim sipas kërkesës së FDT-së.Sa i përket se Njoftimi për kontrata është publikuar me datën 27.05.2027 kurse Licenca në fjalë OE të rekomanduar i është lëshuar me datën 10.06.2024 nga MSH dhe një gjë e tillë nuk është dashur që të pranohet nuk qëndron pasi që operatori ekonomik i rekomanduar Licencën në fjalë e ka pranuar dhe dorëzuar para hapjes së ofertave. Duke pasur parasysh këtë në cilësinë e ekspertit shqyrtues konstatohet se OE i rekomanduar plotëson kriterin e kërkuar në FDT nr.7.1 dhe 7.2 tek kërkesës nr.3 i njëjti ka licencë valide të lëshuar nga organet kompetente konkretisht Ministria e Shëndetësisë andaj bazuar në këtë dhe kërkesën e FDT konstatohet se pretendimi ankimore është i pa bazuar.”

Konstatimi i tretë (III) : “Përgjigja e ekspertit shqyrtues ndaj pretendimit ankimore nr.3: Eksperti shqyrtues sqaron se çfare ka kërkuar AK në FDT tek Kapaciteti teknik dhe profesional pika 9.1 & 9.2. Operatori ekonomik i rekomanduar konform kërkesës së FDT ka prezantuar listën e kontratave, me dëshmi, kontrata, referenca të njëjtat janë valide dhe plotësojnë kriterin e dosjes së tenderit dhe aspektin Ligjor të LPP Nenin 69 mbështetur në këtë konstatohet se pretendimi

ankimore është i pa bazuar.”

Konstatimi i katërt (IV) : “Përgjigja e ekspertit shqyrtues ndaj pretendimit ankimore nr.4: Eksperti shqyrtues sqaron çmimin e procesverbalit. Diferenca e çmimit mes OE-ve është 35,606.40 euro . Andaj bazuar ne këtë dhe mbështetur ne RrPP Nr.001/2023 pikë 10 oferta e OE te rekomanduar nuk klasifikohet si ofertë me çmimin jo normalisht te ulët, vlen te theksojmë edhe këtë se OE i ankues nuk ka prezantuar ndonjë dëshmi që argumenton një fakt te tillë ndaj pretendimi ankimore është i pa bazuar, dhe nuk mund te konstatohet se oferta ka çmimin jo normalisht te ulët.Si përfundim: Se OE i rekomanduar për kontrate konform FDT dhe LPP-së ka dorëzuar edhe dokumentet e ATK-së dhe Gjykatës që dëshmon se OE i rekomanduar nuk ka ndonjë problem ligjore siç pretendon OE ankues. Po ashtu sqarojmë se kriteri ne dosjen e tenderit ka qenë çmimi më i lirë i përgjegjshëm, ne baze te kësaj AK gjatë vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit te ofetave ka vepruar ne harmoni me kriteret e dosjes se tenderi, LPP, Nenin 1, Neni 7 dhe Nenit 59 dhe ka shpallur ofertën me çmimin me te lirë te përgjegjshëm mbështeture edhe ne Nenin 60 paragrafi 1 pika 1.1.”

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik C.I.K, duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Komuna e Gjilanit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore” me numër të prokurimit 651-24-5205-2-1-1 pasi që nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që të kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, për arsyet e elaboruara si më sipër në këtë vendim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- **OE - C.I.K**
- Arkivës së OSHP-së: